

VENDIM
Nr. 9, datë 26.3.2018
NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 30.1.2018, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 70/12 akti, që u përket:

KËRKUESE: Shoqëria “Albatrucks” sh.p.k.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Xhafer Lami, Ardian Bibaja

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 1562, datë 17.4.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2017-1343, datë 19.7.2017, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 131/1/f, 134/1/i dhe 142/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 71, 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuases, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjekteve të interesuara, të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuësja është subjekt i së drejtës tregtare, e cila për qëllime të ushtrimit të veprimtarisë së saj ka blerë një truall me sipërfaqe 5.000 m² dhe ka marrë me qira një sipërfaqe tjetër prej 10.000 m² ngjitur me të. Kontrata e shitblerjes së truallit është lidhur në vitin 1995 midis shoqërisë të përfaqësuar nga ortakja F. B. dhe shitësit K. K., i cili e ka fituar këtë pronë në cilësinë e kryetarit të familjes bujqësore, në bazë të aktit të marrjes së tokës në pronësi. Në vitin 2005, shitësi K. K. dhe bashkëshortja e tij R. K. ia kanë shitur sipërfaqen prej 6000 m² arë shtetasve A. B. dhe F. B., të cilët ua kanë shitur atë shtetasve A. B. dhe Xh. L. (pala e paditur në procesin civil). Këta shtetas e kanë regjistruar këtë pasuri në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Me ardhjen në dijeni të këtij veprimi, kërkuësja i është drejtuar gjykatës me padi për pavlefshmërinë absolute të kontratave të shitblerjes dhe rregullimin e pasojave. Përfundimisht, me vendimin nr. 1561, datë 2.10.2008, të Gjykatës së Apelit Tiranë është vendosur pranimi i padisë, konstatimi i pavlefshmërisë absolute të kontratave të vitit 2005, lirimi dhe dorëzimi i sendit dhe prishja e murit që pengon hyrjen dhe përdorimin e tij. Pasi ky vendim ka marrë formë të prerë dhe është ekzekutuar, kërkuësja i është drejtuar gjykatës me padi me objekt shpërblimin për përdorimin e sendit të paluajshëm që nga data

e paraqitjes së padisë për pavlefshmërinë e kontratave të shitblerjes (7.9.2005) deri në ditën e lirimit e dorëzimit të sendit (6.7.2010).

2. Me vendimin nr. 8835, datë 30.7.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: *“Pranimin e kërkesëpadisë. Detyrimin e të paditurve Xh. L. dhe A. B. që t’i paguajnë solidarisht palës paditëse, shoqërisë “Albatrucks” sh.p.k. shumën prej ... për shkak të posedimit dhe përdorimit të paligjshëm e në keqbesim të pronës së paditësit, truall me sipërfaqe 5.000 m², për periudhën nga data 7.9.2005 deri në datën 6.7.2010.”*

3. Me vendimin nr. 1562, datë 17.4.2014, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit nr. 8835, datë 30.7.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Rrëzimin e kërkesëpadisë së paraqitur nga pala paditëse shoqëria “Albatrucks” sh.p.k. si e pabazuar në prova dhe në ligj.”*. Kundër këtij vendimi, kërkuësja ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

4. Me vendimin nr. 00-2017-1343, datë 19.7.2017, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC).

II

5. **Kërkuësja, shoqëria “Albatrucks” sh.p.k.**, i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) sipas objektit të saj, duke paraqitur këto shkaqe në mënyrë të përmbledhur:

5.1. *Është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor.* Gjykata e Apelit ka cenuar këtë standard, pasi vendimit të saj i mungon baza ligjore dhe argumentimi ligjor mbi të cilin ka mbështetur qëndrimin për zgjidhjen e çështjes ndryshe nga gjykata e shkallës së parë, që kishte pranuar padinë. Ajo gjykatë nuk ka bërë analizë apo interpretim të neneve 297 dhe 198 të Kodit Civil, mbi të cilat është ngritur padia dhe shkak i ligjor, por ka cituar vetëm nenin 306 të Kodit Civil, dispozitë që nuk ka lidhje me shkakun e mosmarrëveshjes. Pra, nuk citohet se cilën dispozitë ka zbatuar gabim gjykata e shkallës së parë dhe si duhej të ishte kuptuar e zbatuar ajo. Në këtë mënyrë, Gjykata e Apelit ka cenuar edhe të drejtën e pronësisë së kërkuëses.

5.2. Kolegji Civil me vendimin e tij ka anashkaluar standardin e arsyetimit, edhe pse në rastin konkret ndodhemi përpara dy vendimeve të kundërta. Kolegji ka vendosur mospranimin e rekursit pa dhënë asnjë arsye se si ka arritur në këtë përfundim. Mungesa e arsyetimit të krijon përshtypjen se nga kërkuësja janë parashtruar pretendime që nuk ekzistojnë, ndërkohë që në rekurs janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkëlqen e parimeve të procesit të rregullt, të cilat gjejnë referim në materialet e çështjes. Kërkuësja ka parashtruar në rekurs se nga Gjykata e Apelit janë injoruar institute të së drejtës së pronësisë lidhur me poseduesin në mirëbesim dhe keqbesim, se është cenuar parimi i disponibilitetit të padisë etj. Po ashtu, ajo ka pretenduar se Gjykata e Apelit ka shkelur standardin e arsyetimit, pasi nuk ka bërë asnjë analizë të neneve ku është bazuar padia dhe se ky vendim është kontradiktor, pasi ndërsa rrëzon tërësisht padinë, shprehet se i padituri ka qenë në mirëbesim deri në ekzekutimin e vendimit të vitit 2008, që do të thotë se deri në vitin 2010, kur liroi pronën, ka qenë në keqbesim.

5.3. *Është cenuar e drejta e aksesit dhe e ankimit.* Duke mos u shprehur për asnjë nga pretendimet e rekursit apo duke mos e kaluar çështjen në seancë, Gjykata e Lartë i ka cenuar kërkuëses të drejtën e aksesit, si dhe të drejtën për t’u dëgjuar e gjykuar. Ajo gjykatë ka cenuar edhe të drejtën e ankimit, pasi në prani të dy vendimeve të kundërta, që i kanë dhënë zgjidhje të ndryshme çështjes, në kushtet kur e vetmja shkallë ankimi ishte Gjykata e Lartë, si dhe nisur nga natyra e pretendimeve të ngritura në rekurs, ajo duhej të mbante një qëndrim të shprehur në lidhje me to.

6. **Subjektet e interesuara, Xhafer Lami dhe Ardian Bibaja**, në prapësimet me shkrim drejtuar Gjykatës, kanë prapësuar sa vijon:

6.1. Kërkuësja, në mënyrë indirekte, kërkon që të përfshijë këtë Gjykatë në zgjidhjen e çështjes, duke bërë trajtim të provave, të rrethanave dhe mënyrës së zbatimit të ligjit, të cilat janë kompetencë ekskluzive e gjykatave të zakonshme. Fakti që Gjykata e Apelit ka rrëzuar padinë e kërkuëses nuk do

të thotë se asaj i është shkelur e drejta për një proces të rregullt, pasi pretendimet e saj janë dëgjuar, shqyrtuar dhe analizuar në seancë gjyqësore, por në përfundim është vlerësuar se janë të pabazuara.

6.2. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë cenuar të drejtat e parashikuara me ligj për kërkuesen dhe ato kanë zhvilluar një proces të rregullt ligjor. Kërkuesja, duke konsideruar si jokushtetues arsyetimin e vendimit të Kolegjit Civil, që ka vendosur mospranimin e rekursit, ngatërron natyrën e gjykimit në dhomën e këshillimit me atë të seancës gjyqësore ose të gjykimit në gjykatat e zakonshme.

6.3. Në nenin 472 të KPC-së janë përcaktuar kufijtë e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, e cila e shqyrton fillimisht rekursin në dhomën e këshillimit, bazuar në nenin 480 të KPC-së. Në përputhje edhe me jurisprudencën kushtetuese, vendimi i Gjykatës së Lartë si nga pikëpamja formale, ashtu edhe substanciale plotëson kërkesat e një vendimi të arsyetuar.

6.4. Gjykata e Lartë nuk i ka cenuar kërkueses as të drejtën e aksesit dhe të ankimit në gjykatë, pasi shkaqet e rekursit janë marrë në shqyrtim nga ana e Kolegjit Civil, i cili ka vendosur mospranimin e tij.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkueses

7. Kërkuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, në kuptim të nenit 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit ligjor 4-mujor. Kërkuesja legjitimohet edhe *ratione materiae*, pasi pretendimet e saj janë të tilla që *prima facie* bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të arsytimit të vendimit gjyqësor

8. Sipas kërkueses, Gjykata e Apelit ka cenuar këtë standard, pasi vendimit të saj i mungon baza ligjore dhe argumentimi ligjor mbi të cilin ka mbështetur qëndrimin për zgjidhjen e çështjes ndryshe nga gjykata e shkallës së parë, që e kishte pranuar padinë. Në vendim nuk citohet se cilën dispozitë ka zbatuar gabim gjykata e shkallës së parë dhe se si duhej të ishte kuptuar e zbatuar ajo. Sipas kërkueses, ky standard është cenuar edhe nga Kolegji Civil, i cili ka vendosur mospranimin e rekursit pa dhënë asnjë arsye se si ka arritur në këtë përfundim. Mungesa e arsytimit të krijon përshtypjen se nga kërkuesja janë parashtruar pretendime që nuk ekzistojnë, ndërkohë që në rekurs janë ngritur pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve të procesit të rregullt, të cilat gjejnë referim në materialet e çështjes. Kërkuesja ka parashtruar në rekurs se nga Gjykata e Apelit nuk janë pasur parasysh institute të së drejtës së pronësisë lidhur me poseduesin në mirëbesim dhe keqbesim, se është cenuar parimi i disponibilitetit të padisë etj. Megjithatë, këto pretendime nuk janë marrë parasysh nga Gjykata e Lartë.

9. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës, si dhe nga neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 13, datë 10.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata, në analizë të dispozitave kushtetuese dhe atyre procedurale, ka theksuar se vendimet gjyqësore duhet jenë të arsyetuara dhe të përmbajnë: një parashtrim të përmbledhur të rrethanave të faktit, provat mbi të cilat bazohen, arsyet për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta, si dhe dispozitivin. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij, ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë (*shih vendimin nr. 55, datë 18.12.2012, të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari

tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Pra, gjyqtari duhet të shpjegojë arsyet e vendimeve të tij, duke iu referuar fakteve për të cilat është zhvilluar procesi, ligjeve të zbatueshme dhe kërkesave të ndryshme të palëve (*shih vendimin nr. 21, datë 4.4.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Zbatimin e këtij parimi, Gjykata e ka vlerësuar rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimet e kundërshtuara janë logjike, kanë kundërthënie, përmbajnë referenca në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respektojnë të gjitha elementet e sipërpërmendura. Detyrimi i gjykatave për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit, si dhe masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 39, datë 25.6.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Në lidhje me vendimet e dhomës së këshillimit, Gjykata, në linjë me jurisprudencën e GJEDNJ-së në këtë drejtim, ka theksuar se ky detyrim nuk mund të interpretohet sikur kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palës ndërgjyqëse. Masa e arsyetimit të vendimit varet nga natyra e tij. Arsyetimi i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit të dhomës së këshillimit, në mënyrë të nënkuptuar, evidenton se kërkuesi nuk ka ngritur asnjë nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse ligjore, që është kusht për pranimin e kërkesës. Kur një gjykatë e lartë refuzon të pranojë një çështje, për arsye se mungojnë shkaqet ligjore për ngritjen e çështjes, një arsyetim i kufizuar nuk e cenon procesin e rregullt ligjor. Kjo formë arsyetimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit (*shih vendimin nr. 13, datë 10.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit, çka mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 3, datë 26.1.2015; nr. 63, datë 23.9.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkueses për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është i pabazuar, pasi vendimet objekt kundërshtimi i plotësojnë kriteret e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese. Këto vendime në pjesën hyrëse përmbajnë palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, disponimet e gjykatave më të ulëta dhe shkaqet e ankimit/ rekursit. Ato nuk rezultojnë të jenë jologjike, të kenë kundërthënie dhe të mos kenë referencë në ligjin e zbatueshëm, duke përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre.

13. Në lidhje me pretendimet e kërkueses për mënyrën e interpretimit të ligjit dhe zgjidhjes së çështjes nga Gjykata e Apelit, ato kanë të bëjnë me çështje të natyrës ligjore dhe, si të tilla, i takojnë për zgjidhje gjykatave të zakonshme. Në juri-sprudencën kushtetuese është theksuar në mënyrë të vazhdueshme se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimin nr. 3, datë 19.2.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Për sa më sipër, pretendimi i kërkueses për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore është i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit dhe të ankimit

15. Sipas kërkueses, duke mos u shprehur për asnjë nga pretendimet e rekursit apo duke mos e

kaluar çështjen në seancë, Gjykata e Lartë i ka mohuar të drejtën për t'u dëgjuar e gjykuar dhe atë të aksesit. Sipas saj është cenuar edhe e drejta e ankimit, pasi në prani të dy vendimeve të kundërta, që i kanë dhënë zgjidhje të ndryshme çështjes, në kushtet kur e vetmja shkallë ankimi ishte ajo Gjykatë, si dhe nisur nga natyra e pretendimeve të ngritura në rekurs, Gjykata e Lartë duhej të mbante një qëndrim të shprehur në lidhje me to.

16. Në nenin 472 të KPC-së janë parashikuar shkaqet për të cilat mund të paraqitet rekurs, kurse në nenin 480 të po këtij Kodi parashikohet se rekursi nuk pranohet, në qoftë se bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji dhe se mospranimi i tij vendoset nga Kolegji i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, pa pjesëmarrjen e palëve. Veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit nuk është një shkelje e së drejtës së palëve për t'iu drejtuar gjykatës, por një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë për zgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon Gjykata Kushtetuese (*shih vendimin nr. 8, datë 26.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata ka vlerësuar se në rekurs, të paktën formalisht, palët përpiqen të ngrenë shkaqe nga ato të parashikuara nga dispozitat procedurale përkatëse dhe, për këtë arsye, shqyrtimi i çështjes nga dhoma e këshillimit e Gjykatës së Lartë nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërisë së tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Kjo është edhe përgjigja që i jep Gjykata e Lartë pretendimeve të ngritura në rekurs nga palët (*shih vendimin nr. 52, datë 14.11.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Kjo sepse, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë (*shih vendimin nr. 8, datë 26.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Bazuar në standardet e mësipërme, edhe në rastin konkret rezulton se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në përputhje me kompetencat e tij ligjore, pasi ka marrë në shqyrtim shkaqet e paraqitura në rekurs, i ka dhënë përgjigje kërkuarës se nuk janë të tilla nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së. Në vlerësimin e Gjykatës, vetëm fakti i ekzistencës së dy vendimeve të kundërta, të dhëna nga gjykatat e faktit apo i mospranimit të rekursit, në dhomën e këshillimit, nuk është i mjaftueshëm në nivel kushtetues për të vënë në dyshim procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për sa kohë që në procesin gjyqësor të kundërshtuar ajo nuk konstatoi cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në ndonjë nga elementet e tij. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim i kërkuarës është i pabazuar.

19. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuarës, shoqërisë “Albatrucks” sh.p.k., për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor janë të pabazuara, ndaj duhet të vendoset rrëzimi i kërkesës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Fatos Lulo

Anëtar kundër: Vitore Tusha

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkuese shoqërinë “Albatrucks” sh.p.k. jam kundër qëndrimit të shumicës për rrëzimin e kërkesës, për rrjedhojë do të paraqes argumentet e mia si vijon:

2. Në ankimin kushtetues individual, kërkuësja ka pretenduar cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit nga ana e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë. Sipas saj, vendimit të Gjykatës së Apelit i mungon baza ligjore dhe argumentimi ligjor mbi të cilin ka mbështetur qëndrimin për zgjidhjen e çështjes ndryshe nga gjykata e shkallës së parë, që e kishte pranuar padinë. Ajo gjykatë nuk ka bërë analizë apo interpretim të neneve 297 dhe 198 të Kodit Civil, mbi të cilat është ngritur padia dhe shkaku ligjor, por ka cituar vetëm nenin 306 të Kodit Civil, dispozitë që nuk ka lidhje me shkakun e mosmarrëveshjes. Për këtë arsye është pretenduar se është cenuar edhe e drejta e pronësisë së kërkueses. Standardi i arsyetimit, sipas kërkueses, është cenuar edhe nga Kolegji Civil, i cili, nisur nga natyra e pretendimeve të ngritura në rekurs, duhej të mbante një qëndrim të shprehur në lidhje me to.

3. Pasi ka marrë në shqyrtim pretendimet e kërkueses, shumica ka vlerësuar se pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar, pasi vendimet objekt kundërshtimi i plotësojnë kriteret e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese. Këto vendime në pjesën hyrëse përmbajnë palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, disponimet e gjykatave më të ulëta dhe shkaqet e ankimit/rekursit. Ato nuk rezultojnë të jenë jologjike, të kenë kundërthënie dhe të mos kenë referencë në ligjin e zbatueshëm, duke përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre (*shih pikën 12 të vendimit*). Në lidhje me pretendimet për procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, shumica ka vlerësuar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në përputhje me kompetencat e tij ligjore, pasi ka marrë në shqyrtim shkaqet e paraqitura në rekurs, i ka dhënë përgjigje kërkueses se nuk janë të tilla nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së. Në vlerësimin e saj, vetëm fakti i ekzistencës së dy vendimeve të kundërta, të dhëna nga gjykatat e faktit apo i mospranimit të rekursit, në dhomën e këshillimit, nuk është i mjaftueshëm në nivel kushtetues për të vënë në dyshim procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për sa kohë që në procesin gjyqësor të kundërshtuar ajo nuk ka konstatuar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në ndonjë nga elementet e tij (*shih pikën 18 të vendimit*).

4. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimit gjyqësor si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse, dhe që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i tij, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm që e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit përbejnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Gjithsesi, Gjykata e ka vlerësuar zbatimin e këtij parimi rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimi gjyqësor i kundërshtuar ka plotësuar në mënyrë të mjaftueshme kërkesat për arsyetimin e tij. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie,

përmban referenca në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Detyrimi i gjykatave për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete e natyrës së vendimit dhe masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme (*shih vendimin nr. 1, datë 19.1.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Duke verifikuar respektimin e standardeve të mësipërme në çështjen konkrete në shqyrtim, vërehet se në vendimin e saj Gjykata e Apelit ka arsyetuar se: “palët e paditura kanë qenë me mirëbesim në rastin konkret dhe nuk ishin të detyruara të dinin se posedimi i tyre ishte i paligjshëm...”. Sipas saj, në gjykimin e zhvilluar ndërmjet të njëjtave palë ndërgjyqëse, që ka pasur si objekt kërkimin e sendit, “nuk është ngritur asnjë pretendim lidhur me shpërblimin e dëmit të ardhur nga zhveshja në mënyrë të paligjshme nga posedimi dhe përdorimi i sendit objekt gjykimi.”. Ndërkohë që ajo arsyeton se me padinë objekt gjykimi “pala paditëse ka ngritur pretendimin për dëmshpërblim nga përdorimi i paligjshëm.”. Më tej, Gjykata ka vlerësuar se: “të paditurit detyrohen t’i paguajnë pronarëve të tjerë shpërblimin për përdorimin e sendit nga dita kur u është njoftuar me shkrim kërkesa e këtij shpërblimi ose nga data e paraqitjes së padisë në gjykatën kompetente.”.

7. Nga sa më sipër, Gjykata e Apelit ka arritur në një përfundim të ndryshëm nga ai i gjykatës së shkallës së parë në lidhje me momentin e marrjes dijeni për posedimin e të paditurve, duke arsyetuar vetëm njërin element faktik ligjor, që lidhet me të qenit në mirëbesim të palës së paditur dhe duke anashkaluar kërkesat e nenit 297 të Kodit Civil, sipas të cilit elementi i mirëbesimit ka rëndësi ligjore deri në momentin e komunikimit të padisë së kërimit të sendit. Nga arsyetimi i Gjykatës së Apelit në lidhje me këtë kërkim rezulton se ajo e lidh momentin e marrjes dijeni për posedimin me momentin e paraqitjes së padisë për shpërblimin e dëmit, ndërkohë që sipas nenit 297 të Kodit Civil rëndësi ka fakti i njoftimit të padisë së pronarit për kërkimin e sendit. Në vlerësimin tim, arsyetimi i Gjykatës së Apelit, nga njëra anë, përbën vlerësim të fakteve që do të ishin kërkesa të një norme të re ligjore, dhe, nga ana tjetër, në kuptim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, nuk përmban referencë në ligjin që është në fuqi dhe që është i zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes konkrete të paraqitur asaj gjykate për zgjidhje. Edhe pse zbatimi dhe interpretimi i normës ligjore është, së pari, detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshme, Gjykata e Apelit, në vlerësimin tim, e ka anashkaluar këtë detyrim, duke mos arritur të arsyetojë dhe të argumentojë në mënyrë të qartë në lidhje me mënyrën e zbatimit të dispozitave ligjore të Kodit Civil që lidhen me kërkimin për shpërblimin e dëmit. Ajo është fokusuar vetëm në dispozitat që i referohen posedimit me mirëbesim të palës së paditur, por pa analizuar edhe dispozitat e tjera që referojnë në kërkimin për shpërblimin e dëmit, që është objekt i padisë.

8. Edhe pse kërkuesja ka parashtruar në Gjykatën e Lartë pretendime në lidhje me mënyrën e arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Apelit dhe atë të interpretimit të dispozitave materiale të Kodit Civil të zbatueshme, çka lidhet thellësisht me kompetencën e asaj Gjykate për interpretimin dhe dhënien e kuptimit përfundimtar normës ligjore, ato nuk u morën parasysh, duke u vendosur mospranimi i rekursit në dhomën e keshillimit.

9. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Ky raport ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale në bazë të nenit 131/1/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimin nr. 19, datë 2.4.2012, të Gjykatës Kushtetuese*). Ky qëndrim lidhet me rolin e Gjykatës së Lartë si gjykatë e ligjit, i cili është i një natyre të pazëvendësueshme. Kjo e fundit i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta bërë vetë këtë rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta (*shih vendimin nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ

të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimin nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Bazuar në sa më sipër, duke iu referuar shkaqeve të ngritura në rekurs në lidhje me mosrespektimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nga ana e Gjykatës së Apelit, si pretendim me natyrë kushtetuese, dhe shkaqeve të tjera me natyrë ligjore, të cilat në kuptim të nenit 472 të KPC-së janë në kompetencë të Gjykatës së Lartë, ajo duhet të kishte vlerësuar bazueshmërinë e tyre në mënyrë të shprehur dhe të jepte në përfundim një vendim të arsyetuar në lidhje me këto pretendime. Vetëm në këtë mënyrë do të garantohej e drejta e kërkuar për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar dhe lidhur me të edhe e drejta për akses efektiv në gjykatë sipas standardeve të vendosura tashmë nga jurisprudenca kushtetuese.

12. Në përfundim, nisur nga rëndësia thelbësore që merr respektimi i standardit kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor në drejtësi të garantimit të aksesit në gjykim, por edhe të administrimit të drejtësisë dhe për sa kohë kjo kërkesë nuk është respektuar nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, vlerësoj se pretendimi i kërkuar në lidhje me procesin e zhvilluar në atë gjykatë është i bazuar, ndaj shumica duhet të kishte vendosur pranimin e kërkesës në lidhje me këtë kërkim të saj.

Anëtare: Vitore Tusha